

**AKT THEMELIMI
PER KRIJIMIN SI PERSON JURIDIK TE SHOQERISE
"FRIENDS-2005" SH.P.K.**



Ky akt themelimi u perpilua nga ortaket themelues :

1. **Ardian Nelo**, i biri i Niaziut, i datelindjes 1969, lindur ne Berat dhe banuese ne Tirane, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i pajisur me pashaporten Nr.1242711.
2. **Piro Angjeli**, i bin i Llazarit, i datelindjes 1975, banues ne Tirane, i njohur prej meje , madhor me zotesi te plote juridike e per te vepruar.
3. **Geron Cela**, i biri i Tekiut ,lindur me 1968, banues ne Tirane , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar,i paisur me pashaporten Nr.0321945.
4. **Myzafer Averiku**, i biri i Shyqyriut, i datelindjes 1941,banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, i paisur me pashaporten Nr.0443905.

Te quajtur me poshte ortake themelues, te cilet ne perputhje me ligjin nr.7632, date 4/11/1992 "Per dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te Kodit Tregetar", me ligjin nr.7368, date 19/11/1992 "Per shoqerite tregetare" dhe ligjin nr.7667, date 23/01/1993 "Per regjistrin tregetar", krijojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar si vijon:

1.1. Formimi.

Ortaket themelues formojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me ligjin nr.7638, date 19/11/1992 "Per shoqerite tregetare"

1.2.Emri i Shoqerise.

Emri i shoqerise do te jete " FRIENDS-2005" sh.p.k

1.3. Selia e Shoqerise.

Shoqeria "FRIENDS-2005"sh.p.k . do te kete qendren e veprimtarise se saj ne Kompleksi ndrtimore "Friends" ish parku i autopuxave Tirane

1.4. Kohezgjatja e Shoqerise

Afati i veprimtarise se shoqerise do te jete mbi 10 vjet. Me mbarimin e ketij afati asambleja e ortakeve ka te drejte te zgjate afatin e veprimtarise se

shoqerise ose me mbylle aktivitetin e saj edhe para afatit te percaktuar ne kete akt konform legjislacionit ne fuqi.

1.6. Objekti i veprimtarise.

Objekti i veprimtarise te shoqerise eshte si vijon:

- Shoqeri investimesh dhe tregtimi te apartamente banimi, lokale tregtimi dhe sherbimi , zyra , parkime, garazhe, etj.
- Eksport - import, tregtim dhe prodhim te materialeve te ndertimit.
- Krijimi i linjave dhe njesive te vogla dhe te medha per prodhim dhe tregtim te enegjigjije elektrike , me burime natyrore dhe alternative.
- Import- eksport, tranzitim, ndermjetesim, furnizim me energji elektrike.
- Import - eksport ,tranzitim dhe tregtim te linjave te prodhimit dhe teknologjive per prodhimin dhe shfrytezimin e burimeve energjitike.
- Krijimin e agjensive te transportit rrugor, ujor, ajror, agjnesive te punesimit dhe komisione ndermjetesimi.
- Krijimin e agjensive , institute per zbatim, kerkim e zhvillim te tekonojgji ve te reja .
- Organizimin panair , ekspozita, manifestimeve kulturore dhe sportive.
- Shtypshkrime tipografike, postera, flet palosje dhe shtepi botuese.
- Veprimtari siper marrje industriale, transport te mallrave dhe transport te udhetareve.

II. KAPITALI

2.1. - Kapitali

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njeqind mije) leke, kontribut i ortakeve themelues eshte :

- | | | |
|------------|---------|---------------------------------------------------|
| 1. Ardian | Nelo | zoterues i 50% te kuotave te kapitalit themeltar. |
| 2. Piro | Angjeli | zoterues i 25% te kuotave te kapitalit themeltar. |
| 3. Myzafer | Averiku | zoterues i 15% te kuotave te kapitalit themeltar. |
| 4. Geron | Cela | zoterues i 10% te kuotave te kapitalit themeltar. |

Asambleja e ortakeve ka te drejte te beje shtese te kapitalit themeltar te shoqerise.

2.2 - Fitimi

Fitmi i realizuar nga aktiviteti i shoqerise i takon ortakeve themelues ne masen :

- | | | |
|------------|---------|---------------------------------------------------|
| 1. Ardian | Nelo | zoterues i 50% te kuotave te kapitalit themeltar. |
| 2. Piro | Angjeli | zoterues i 25% te kuotave te kapitalit themeltar. |
| 3. Myzafer | Averiku | zoterues i 15% te kuotave te kapitalit themeltar. |
| 4. Geron | Cela | zoterues i 10% te kuotave te kapitalit themeltar. |

III. STRUKTURA JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

3.1- Organet e Shoqerise jane:

- Asambleja e ortakeve
- Administratori i shoqerise eshte z..DORIAN BACU ..


IV. DISPOZITE E FUNDIT


4.1. Ndryshimet ne kete AKT mund te behen vetem me shtese me shkrim dhe te miratuar nga asambleja e ortakeve.


Pjese e pandare e ketij akti eshte statuti i shoqerise i cili nenshkruhet rregullisht nga themeluesit e shoqerise.


4.2. Ky akt themelimi u hartua ne Tirane ne 4 kopje origjinale, i cili nenshkruhet rregullisht konform ligjes.


THEMELUESIT

1) - Ardian Nelo


2) Myzafer Averiku


3) Piro Angjeli


4) GERON CELA




REPUBLIKA E SHQIPERISE
 DHOMA E NOTERISE TIRANE
 Nr.....552.....Rep, Nr...191...kol.



VERTETIM

Ne Tiranë, sot me datën ...10.03...2005 (Dymije e pese) ne zyrën e noterise Tiranë me adrese Rr"Paatoret e Rilindjes", para meje Notere Elida Magani u paraqiten personalisht:

1. Ardian Nelo i biri i Niaziut i datelindjes 1969, lindur ne Berat dhe banues ne Tiranë, me zotesi te plote juridike per te vepruar me Nr. pashaporte 1242711,
2. Piro Angjeli i bin i Llazarit i datelindjes 1975, banues ne Tiranë i njohur prej meje , madhore me zotesi te plote juridike e per te vepruar.
3. Geron Cela, i biri i Tekiut, lindur me 1968 banues ne Tiranë , madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, e paisur me Pashaporten Nr.0321945
4. Myzafer Averiku i biri i Shygyritur i datelindjes 1941, banues ne Tiranë, i paisur me Pashaporten Nr.0443905

Te cilet kane redaktuar kete AKT THEMELIMI , me vullnetin e tyre te liree te plote dhe e nenshkruajne rregullisht para meje dhe une Noter e vertetoj sipas ligjit.

NOTERE
 ELIDA MAGANI

STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" FRIENDS-2005 SH.P.K.



Ky statut perpilohet nga :

1. **Ardian Nelo**, i biri i Niaziut, i datelindjes 1969, lindur ne Berat dhe banuese ne Tirane, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i pajisur me pashaporten Nr.1242711.
2. **Piro Angjeii**, i bin i Llazarit, i datelindjes 1975, banues ne Tirane, i njohur prej meje , madhor me zotesi te plote juridike e per te vepruar.
3. **Geron Cela**, i biri i Tekiut ,lindur me 1968, banues ne Tirane , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar,i paisur me pashaporten Nr.0321945.
4. **Myzafer Averiku**, i biri i Shyqyriut, i datelindjes 1941,banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, i paisur me pashaporten Nr.0443905.

Te quajtur me poshte ortake themelues, me vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me me ligjin Nr.7632, date 4.11.1992 " Per dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te Kodit Tregtar", me ligjin Nr. 7638, date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare ", si dhe me aktet e tjera te legjislacionit shqiptar qe trajtojne keto ceshtje, krijojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar , si vijon:

KREU I

NENI 1
FORMA

Ortaket e mesiperem krijojne nje Shoqeri me Pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne Shqiperi dhe me dispozitat e ketij Statuti.

NENI
EMRI I SHOQERISE

Emri i shoqerise do te jete " FRIENDS-2005"sh.p.k.



NENI 3 SELIA E SHOQERISE

Selia qendrore e shoqerise do te jete ne "kompleksi ndertimor "Friends", ish parku i autobuzave Tirane .

Shoqeria ka te drejte qe me vendim te asamblese se ortakeve mund te hape dege. Zyra, filiale ose perfaqesi te shoqerise ne qytete te tjera te Shqiperise.

NENI 4 KOHEZGJATJA

Shoqeria do te kete kohezgjatje mbi 10 vjet. Si date fillestare merret data e regjistrimit te saj ne Gjykatën e Tiranës.

NENI 5 OBJEKTI I SHOQERISE

Objekti i veprimtarise te shoqerise eshte si vijon:

- Shoqeri investimesh dhe tregtimi te apartamente banimi, lokale tregtimi dhe sherbimi , zyra , parkime, garazhe, etj.
- Eksport - import, tregtim dhe prodhim te materialeve te ndertimit.
- Krijimi i linjave dhe njesive te vogla dhe te medha per prodhim dhe tregtim te enegjigjie elektrike , me burime natyrore dhe alternative.
- Import- eksport, tranzitim, ndermjetesim, furnizim me energji elektrike.
- Import - eksport ,tranzitim dhe tregtim te linjave te prodhimit dhe teknologjive per prodhimin dhe shfrytezimin e burimeve energjitike.
- Krijimin e agjensive te transportit rrugor, uhor, ajror, agjnesive te punesimit dhe komisione ndermjetesimi.
- Krijimin e agjensive , institute per zbatim, kerkim e zhvillim te tekologjive te reja .
- Organizimin panairë , ekspozita, manifestimeve kulturore dhe sportive.
- Shtypshkrime tipografike, postera, flet palosje dhe shtepi botuese.
 - Veprimtari sipermarrije industriale, transport te mallrave dhe transport te udhetareve.



KREU II **KAPITALI THEMELTAR , KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT** **THEMELTAR DHE TRANSFERIMI**

NENI 6

Kapitali themltar shoqerise eshte 100.000 (njqind mije) leke, kontribut i ortakeve themelues si me poshte vijon:

- | | | |
|------------|---------|---------------------------------------------------|
| 1. Ardian | Nelo | zoterues i 50% te kuotave te kapitalit themeltar. |
| 2. Piro | Angjeli | zoterues i 25% te kuotave te kapitalit themeltar. |
| 3. Myzafer | Averiku | zoterues i 15% te kuotave te kapitalit themeltar. |
| 4. Geron | Cela | zoterues i 10% te kuotave te kapitalit themeltar |

NENI 7

KONTRIBUTET

Kontributi i percaktuar ne nenin 6 te ketij statuti , i takon ortakeve themelues sipas pjeseve te tyre takuese te percaktuara ne nenin 6 te ketij statuti.

NENI 8

Fitimi I realizuar nga aktiviteti i shoqerise i takon ortakeve themelues sipas pjeseve takuese qe zoterojne ne kapitalin themeltar.

NENI 9

TRANSFERIMI 1 PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR

Kuotat e kapitalit te shoqerise mund te transferohen me ane aktesh mes te gjalleve dhe me trashegimi. Transferimi i kuotave te kapitalit te shoqerise nuk i nenshtrohet asnje lloj kufizimi, ne qofte se ndodh ne rast vdekje.

KREU III

MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I **SHOQERISE**

**NENI 10
ASAMBLEJA E ORTAKEVE**

Asambleja e ortakeve organizon, drejton dhe kontrollon gjithë aktivitetin e shoqërisë. Ortaket perballojnë humbjet e shoqërisë deri me kufirin e vlerës së kontributit të tyre.

**NENI 11
DREJTIMI SHOQËRISE**

Organi më i lartë drejtues i shoqërisë do të jetë asambleja e ortakeve. Asambleja e ortakeve mbledhet si rregull dy herë në vit, si dhe sa herë që gjykohet e arsyeshme.

**NENI 12
KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE**

- Asambleja e ortakeve vendos për këto çështje:
- Emeron administratorin e shoqërisë.
 - Emeron ekspertet kontabel.
 - Miraton bilancin vjetor.
 - Vendos për shpërndarjen e dividendit të shoqërisë.
 - Ben ndryshime në statut.
 - Vendos për zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar.
 - Në rast të shpërndarjes së shoqërisë cakton likuidatorin dhe e shkarkon atë kur perfundon likuidimi.
 - Vendimet e asamblese nënshkruhen nga ortaket dhe vertetohen nga noteri.

**NENI 13
ADMINISTRATORI**

Shoqëria do të administrohet nga DORIAN BACU

**NENI 14
KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT**

Administratori i shoqërisë emërohet nga asambleja e ortakeve, i cili përgjigjet për zbatimin e vendimeve të asamblese së ortakeve
Administratori ka këto kompetenca:

- Te beje drejtimin e shoqerise .
- Te perpiloje dhe nenshkruaje kontratat dhe aktet juridike qe kane te bejne me veprimtarine e shoqerise;
- Te hapi llogari rrjedhese bankare prane bankave shqiptare ose te huaja.
- Te perfaqesoje shoqerine ne mardhenie me te tretet.
- Te emerojne nepunes te rangjeve te ndryshme per veprime te veçanta teknike ose per nje kategori te caktuar veprimesh;
- Te beje gjithçka tjeter qe konsideron te dobishme dhe qe eshte ne perputhje me formen e ketij Statuti e te Aktit Themelues si dhe me legjislacionin shqiptar ne fuqi, per te arritur qellimin dhe objektin e veprimtarise se shoqerise.

KREU IV

LIBRAT E LLOGARISE, BILANCI, FITIMI, SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI.

NENI 15


Shoqeria eshte e detyruar te mbaje pervec dokumentacinit kontabel qe kerkon legjislacioni ne fuqi edhe keto libra :

- 1- Libri i ortakeve, ne te cilin shenohen emrat e plote te ortakeve dhe kuotat qe secili ka ne kapitalin e themelimit.
- 2- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te asamblese.
- 3- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te Admimstratorit
- 4- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te organit sindikal.

NENI 16

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, EKSPERTI KONTABEL

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i pare financiar do te filloje pas regjistrimit te shoqerise si person juridik dhe do te perfundoje me 31 Dhjetor 2003. Llogarite vjetore, inventaret, raportet mbi operacionet e veçanta te hartuara nga admimstratori miratohen ng aasambleja e ortakeve. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.



**NENI 17
ZGJATJA E AFATIT**

Zgjatja e afatit të shoqërisë që është përcaktuar në këtë statut, mund të vendoset nga asambleja e ortakëve. Në rast se në shoqëri pranohen ortakë të tjerë konform legjislacionit në fuqi, atëherë vendimet merren me shumicën e ortakëve që zoterojnë mbi 3/4 e pjesëve të kapitalit themeltar.

KREU V

**NENI 18
AKTIVITETI FINANCIAR**

Në çdo mbyllje çdo viti financiar administratori bën inventarin dhe llogarinë vjetore në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për kontabilitetin, si dhe hartohet një raport me shkrim Bilancit i bashkëngjiten:

Një situacion mbi garancitë e dhëna nga shoqëria.

Një situacion mbi sigurimet e bera nga shoqëria.

Raporti i administratoreve përfshi gjendjen gjatë vitit financiar të kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtaritë e mundshme që janë zhvilluar nga data e mbylljes së vitit financiar deri në ditën që është hartuar ky raport.

Dokumentet vihen në dispozicion të ekspertëve kontabel të autorizuar, të pakten një muaj para mbledhjes së asamblese.

NENI 19

Fitime neto të shoqërisë do të konsiderohen fitimet që rezultojnë pas zbritjes nga të ardhurat e të gjitha shpenzimeve që kanë lidhje me aktivitetin e shoqërisë, detyrimet fiskale, shoqërore, demtimet, amortizimet, etj, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Shoqëria krijon fondin rezerve dhe fonde të tjera të veçanta financimi.

Perberja, shuma e përgjithshme, burimet për krijimin e fondit rezerve, përdorimi dhe rregullimi i çdo fondi të veçantë caktohet nga asambleja e ortakëve në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Në përputhje me Neion 213 të ligjit "Për shoqëritë tregtare" nga fitimi i rezervuar gjatë vitit financiar lihet me një shumë me vlerë 1/20 e kapitalit, e cila destinohet për krijimin e një fondi "rezerve e domosdoshme".

NENI 20
PRISHJA E SHOQERISE

Shoqeria priset me kalimin e afatit te caktuar ne statut dhe per arsye te parashikuara ne ligj . Shoqeria priset perpara afatit me vendim te Asamblese ortakeve .

NENI 21

Rastet e pavlefshmerise se shoqerise ose te nje akti qe ndryshon statutin si dhe bashkimi dhe ndarja e shoqerise behet ne perputhje me dispozitat e ligjit "per Shoqerite Tregtare".

NENI 22

Kur shoqeria priset ajo kalon ne likujdim dhe ne kete rast emertimit te shoqerise i shtohet shenimi " Shoqeri ne likujdim e siper ". Shoqeria edhe gjate procesit te likujdimit vazhdon si person juridik deri ne perfundimin e procesit te likujdimit.Prishja e shoqerise eshte me pasoje ndaj te treteve vetem pas publikimit te prishjes ne regjistrin tregtar.

NENI 23


Per te perfunduar procesin e likuidimit, aambleja e ortakeve emeron nje ose disa persona si likujdues te cilet perfaqesojne shoqerine. kuiduesi perpilon bilancin financiar likujdon tek te tretet detyrimet e shoqerise, shet aktivet e shoqerise dhe ndan tepricat ne dispozicion.

NENI 24

Ne perfundim te mbylljes se likujdimit, ortaket thirren qe te vendosin per bilancin financiar perfundimtar, per aktin e rregullshmerise, per admimstrimin e tij nga ana e likujduesit dhe per heqjen e mandatit te likuiduesit, si dhe per t'u evidencuar mbyllja e likuidimit. Dokumentat e mesiperme miratohen nga Asambleja e ortakeve .

NENI 25

Kur shoqeria likujdohet pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, u kthehen pronareve.



Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise dhe fondet fillestare ndahen ndermjet ortakeve ne perpjestim me kuotat e vena pasi te jene likuiduar kreditoret.

NENI 26 DISPOZITA TE FUNDIT

Shoqeria ka te drejte te punesoje punonjes qe i nevojiten per te ushtruar veprimtarine e saj. Punesimi behet sipas kushteve te percaktuara ne legjislacionin e punes se Republikes se Shqiperise, si dhe rregullave te vena ne kontraten e vecante te punesimit qe lidhet midis punedhenesit e punonjesit. Te gjitha problemet qe do te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise private te kesaj shoqerie do te zgjidhen sipas rregullave te percaktuara ne statutin dhe legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise. Kur mosmarreshjet nuk zgjidhen ne mirekuptim kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e shkalles se pare Tirane.

NENI 28

Ky statut firmoset me vullnetin e lire te ortakeve themelues.

THEMELUESIT

1) Ardian Nelo



2) Myzefer Hoxhaku
Ullurani.

3) Piro Angelini

4) GEROMI CECALI

REPUBLICA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr.....553.....Rep, Nr. 192.....kol.



VERTETIM

Ne Tirane, sot me daten .../10/03/...2005 (Dymije e pese) ne zyren e noterise Tirane me adrese Rr" Puntoret e Rilindjes", para meje Notere Elida Magani u paraqiten personalisht:

1. Ardian Nelo i biri i Niaziut i datelindjes 1969, lindur ne Berat dhe banuese ne Tirane, me zotesi te plote juridike per te vepruar me Nr. pashaporte 1242711,
2. Piro Angjeli i bin i Llazarit i datelindjes 1975, banues ne Tirane i njohur prej meje , madhore me zotesi te plote juridike e per te vepruar.
3. Geron Cela, i biri i Tekiut , lindur me 1968 banues ne Tirane , madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, e paisur me Pashaporten Nr.0321945
4. Myzafer Averiku i biri i Shyqyriut i datelindjes 1941, banues ne Tirane, i paisur me Pashaporten Nr.0443905

Te cilet kane redaktuar kete STATUT , me vullnetin e tyre te liree te plote dhe e nenshkruajne rregullisht para meje dhe une Noter e vertetoi sipas ligjit.

NOTERE
ELIDA MAGANI